



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN
E MJEDISIT TË KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA
ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL
PROTECTION AGENCY

CILËSIA E AJRIT NË PRISHTINË GJATË PERIUDHËS 01-09 DHJETOR 2015

Cilësia e ajrit në Prishtinë monitorohet përmes sistemit të matjeve automatike që do të thotë se bëhen matje kontinuale pa ndërprerje. Parametrat që monitorohen janë: Dyoksidi i sulfurit (SO₂), Monoksidi i karbonit (CO), Dyoksidi i azotit (NO₂), Ozoni (O₂), grimcat e suspenduara në ajër PM10 dhe PM2.5.

Nga analiza e rezultateve të fituara nga monitorimi automatik i cilësisë së ajrit është konstatuar se gjatë periudhës monitoruese 01-09.12.2015 janë paraqitë tejkalime të vlerave kufitare ditore me PM10. Vlera kufitare ditore e lejuar për mbrojtjen e shëndetit të njeriut është 50ug/m³.

Gjatë tërë këtyre ditëve janë regjistruar 7 ditë (raste) me tejkalime të vlerave kufitare ditore që d.m.th. vetëm dy ditë kanë qenë përqendrimet e PM10 brenda kufijve të lejuar (shih fig.1). Ndërsa gjatë një viti lejohen 35 ditë me tejkalime të vlerave kufitare ditore.




Fig.1. Përqendrimi i PM10 dhe PM2.5 në Prishtinë

Vlera maksimale e përqendrimit të PM10 ka arritur në 115.44 me datë 04.12.2015 dhe është 2.3 herë më e lartë se vlera e kufitare e lejuar. Po ashtu edhe përqendrimi i PM2.5 është i ngritur në krahasim me

muajt e kaluar. Kësaj gjendje i kontribuojnë jo vetëm shkarkimet nga transporti, industria por edhe konsumimi i lëndëve djegëse që përdorën për ngrohje si dhe kushtet jo të favorshme për disperzionin e ndotësve që shkarkohen në ajër nga burimet e lartë përmendura e të cilët në këtë raste akumulohen në afërsi të tokës dhe nuk shpërndahen lartë në atmosferë.

Përqendrimet e ndotësve të gaztë sikur janë SO₂, CO, NO₂ dhe O₃ nuk kanë tejkaluar vlerat kufitare të lejuara, por megjithatë në krahasim me muajt e tjerë të vitit kanë pësuar një ngritje të vlerave gjate kësaj periudhe për te cilën jemi duke e shqyrtuar (shih fig.2).




Fig. 2. Përqendrimi i ndotësve të gaztë në Prishtinë

Konkluzione dhe Rekomandime

- Nga analiza e rezultateve të lartë përshkruara është konstatuar se përqendrimet e larta të PM10 e bëjnë që cilësia e ajrit në Prishtinë të jetë jo e kënaqshme.
- Kësaj gjendje i kontribuojnë shkarkimet e ndotësve nga burimet e lartpërmendura sikur janë industria, transporti dhe konsumimi i lendeve të ngurta djegëse që përdoren për ngrohje si dhe kushtet e pafavorshme meteorologjik për disperzionin e ndotjes që emetohet në ajër.
- Gjate këtyre ditëve për te cilat jemi duke shqyrtuar gjendjen e cilësisë së ajrit në Prishtinë ka mbretëruar një mot me mjegull të dendur (dukshmëri <30 m) dhe lagështi të lartë të ajrit mbi 85% si dhe mungesë e erës dhe kur këtyre kushteve u shtohen edhe shkarkimet e ndotësve në ajër atëherë vije deri te krijimi i gjendjes së smogut (i thirrur smogu i Londrës) që është karakteristik për paraqitjen e tij gjate sezonit dimëror dhjetor- janar dhe i cili shkakton eksitim të bronkeve dhe kollitje.
- Në këto raste rekomandohet që kategoria e ndjeshme (personat me probleme nga sëmundjet e organeve respiratore të mos qëndrojnë gjate në ambiente të tilla.
- Të reduktohen lëvizjet e panevojshme me automjete sidomos në zonat e frekuentuara nga këmbësorët etj.

Raporti është përgatitur nga:

Letafete Latifi, Udhëheqëse e IHMK dhe **Shkumbin Shala**, specialist i cilësisë së ajrit në IHMK